

**Data 6.02.2025
Ora 12:26**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

PJESËMARRJA:

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj. M. Çelmeta, znj. P. Doçaj, z. B. Kodra**
- **Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)**

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 12. Jemi pak me vonesë. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike, të shoqërisë civile dhe të mirëseardhurit si gjithmonë përfaqësues të medieve. Në mbledhjen e ditës së sotme kemi vetëm një projektakt për të diskutuar, atë “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektaktit, sipas

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

procedurës së përcaktuar në rregulloren tonë, fillimisht pyesim anëtarët e Rregullatorit, më tej përfaqësuesit e partive politike nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë? Nuk ka. Po, zoti Nuri? Në rregull. Do t'ju jepet fjala sapo të mbarojmë me rendin e ditës.

Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Nga administrata, një relativitet të shkurtër, ju lutem.

Znj. P. Doçaj: Faleminderit! Objekt shqyrtimi i kësaj mbledhjeje është projektvendimi "Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025", i cili ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat teknike të kësaj flete, që do të përdoret për zgjedhjet në Kuvend. Në referim të nenit 97, pika 1, aty ku parashikohet që për zgjedhjet për Kuvend zgjedhësi voton me një fletë votimi me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore, në referim të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja, fletët e votimit do të jenë prej letre, me ngjyrë dhe trashësi ose element konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajë element sigurie sipas përcaktimeve dhe akteve normative të KQZ-së. Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese, të cilat nuk lexohen me sy të lirë. Përveç elementeve të sigurisë së fletës, fleta e votimit do të përmbajë edhe disa elemente teknike në formën e kodeve, që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe element identifikues që nuk lexohen me sy të lirë, siç është edhe QR Kodi. Elementet e sigurisë dhe elementet teknike janë të përcaktuar në mënyrë të detajuar në lidhjen nr.1 që i bashkëlidhet këtij projektvendimi, që është pjesë integrale e projektvendimit. Komisioni Rregullator mendojmë që nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese në lidhje me dimensionin e fletës, ky është ai elementi që ndryshon nga zgjedhjet e mëparshme, për arsye se ne mendojmë që

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

dimensionet e fletës së votimit do të duhet të përcaktohen në momentin kur regjistrohen subjektet zgjedhore në fletën e votimit. Pra, kjo përmasë do të duhet të përcaktohet në një moment të dytë. Duke qenë se ne tashmë kemi një eksperiencë dhe një praktikë të konsoliduar në lidhje me përcaktimin dhe karakteristikat e fletës së votimit të përdorur edhe në zgjedhjet e mëparshme, kryesisht të vitit 2021 dhe vitit 2023, propozohen specifikimet teknike të cilat janë në lidhjen nr.1, janë përdorur po njësoj në zgjedhjet e mëparshme dhe kjo lidhje i bashkëlidhet këtij projektvendimi. Konkretisht, letra që do të përdoret për prodhimin e fletës së votimit do të jetë letër e thurur, me dy shtresa, e cila në trupin e letrës ka disa fibra karboni, të cilat shikohen me sy të lirë ose me rreze ultravioletë, si dhe lejon printimin e elementeve shtesë të sigurisë. Dendësia e saj do të jetë jo më e vogël se 90 g/m^2 , e cila është një trashësi e përdorur jo zakonisht, pra përdoret në rastet e fletës së votimit dhe nuk lejon leximin e fletës së votimit apo të votimit në pjesën e pasme të saj. Risia e këtyre zgjedhjeve është edhe votimi i zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Fleta e votimit që do të përdoret për këta zgjedhës do të jetë e njëjtë me fletën e votimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por me një shenjë dalluese, ashtu siç e përcakton edhe neni 25/1, pika 2. Ne propozojmë që shenja dalluese e parashikuar të jetë akronimi i votuesve nga jashtë, pra të jetë akronimi VJ, që do të printohet përbri fletës së votimit, siç citohet edhe në lidhjen bashkëlidhur projektvendimit. Bashkëlidhur projektvendimit keni edhe specimenin e fletës së votimit për të dyja fletët e votimit, për fletën e votimit që do të përdoret për zgjedhësit brenda vendit dhe fletën e votimit që do të përdoret për zgjedhësit jashtë vendit. Kjo në mënyrë të përmbledhur për sa u përket specifikimeve teknike për sa i përket fletës së votimit.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Doçaj! Aty në ekran është paraqitur ngjyra e fletës së votimit edhe elementet e tjera të dukshme. Fillojmë me shqyrtimin e

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

projektvendimit. Diskutime në parim fillimisht. Kolegë, kush dëshiron të diskutojë në parim? Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Përshëndetje të nderuar pjesëmarrësve në këtë sallë dhe të gjithë të interesuarve që na ndjekin online! Pa dyshim që është një vendim ose një çështje e rëndësishme e rendit të ditës, bëhet fjalë për miratimin e specifikimeve teknike të dy fletëve të votimit, pra jo dy fletëve si sasi, por të dyja fletëve si lloj për votimin nga brenda dhe për votimin nga jashtë. Në këtë propozim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve na ka paraqitur në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 specifikimet që duhet të ketë apo karakteristikat e fletës së votimit, si për fletën e votimit nga brenda, ashtu edhe për atë nga jashtë. Në funksion të zbatimit me përpikëri të nenit 98, unë kam një pyetje për administratën: në dukje shoh që u jeni përmbajtur karakteristikave të fletës që dikton neni 98, por nuk shoh këtu përmasën e trashësisë së fletës. A keni ju një përmasë të trashësisë së fletës, e cila duhet konkretizuar, mendoj, në këtë lidhje, me qëllim që edhe prodhuesi të jetë i saktë në atë se çfarë do të prodhojë dhe, nga ana tjetër, a kemi një përmasë të fletës së zakonshme dhe a dallon në përmasa fleta e votimit me atë të zakonshmen?

Znj. I. Nano: Zoti Kodra, lidhur së pari me trashësinë e fletës së votimit, pastaj me përmasat.

Z. B. Kodra: Për sa i përket trashësisë, elementi që kemi përdorur deri më sot për të matur trashësinë ka qenë dendësia e fletës së votimit, pra përcaktimi 90g/m^2 tregon që letra që përdoret ku printohet fleta e votimit është një letër më e trashë se letra e zakonshme, që është $70\text{-}80\text{ g/m}^2$, ajo letra që përdorim nëpër zyra. Për sa i përket trashësisë specifike të kësaj letre, ajo është 117 mikrom, këtë e kam

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

konfirmuar, por është një njësi shumë e vogël e padallueshme me sy të lirë, pas mikromi është një me njëmijta e milimetrit.

Znj. I. Nano: Megjithatë, është një karakteristikë teknike.

Z. B. Kodra: Karakteristikë teknike kjo është, e kam këtë të dhënë, 117 mikrom. Nuk e kemi shtuar, pasi kemi menduar që e dhëna 90 g/m² ka qenë e mjaftueshme për të identifikuar që kjo është...

Znj. H. Vukaj: E dhëna 90 g/m² përfaqëson dendësinë e fijeve të përmbajtjes së asaj flete, por nuk përfaqëson spesorin në fletë, pra trashësinë e fletës, që është një element që kërkohet nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe i domosdoshëm në kushtet e ekuivalencës apo të krahasimeve të mëtejshme të hamendësuar që mund të bëhen në rastin e një flete, e cila është prodhuar jashtë atij prodhuesi. Kështu që nuk mendoj që përmbush edhe elementin trashësi dhe meqenëse e dhëna ekziston, mendoj që duhet të futet dhe do ta propozojmë më pas. Edhe një pyetje tjetër: në përzgjedhjen e këtij kodi, e kësaj ngjyre të fletës, e këtij pigmenti, ju e keni përzgjedhur se është më e përshtatshme ,apo e keni përzgjedhur në funksion të një kostoje më të ulët për prodhuesin apo për fondin në dispozicion?

Z. B. Kodra: Kjo nuk ka të bëjë fare me koston, pasi për prodhimin njësoj është për çdo lloj ngjyre. Kodi i propozuar i ngjyrës është kodi i ngjyrës me të cilën është printuar fleta e votimit në zgjedhjet e vitit 2021. Përgjithësisht me këtë lloj kodi është printuar edhe në zgjedhjet pararendëse kjo lloj flete votimit.

Znj. H. Vukaj: Në vitin 2023 kemi përdorur kode të ndryshme, ndaj iu referova. Mos ndoshta ju bëni repiticionin e kësaj ngjyre për hir të koston apo ka ndonjë...

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

Z. B. Kodra: Nuk ka të bëjë me koston.

Znj. H. Vukaj: Nuk ka të bëjë me koston.

Z. B. Kodra: Në zgjedhjet e vitit 2023 Kodi kërkonte që të votohej me dy fletë votimi të ndryshme, pra kanë qenë dy ngjyra të ndryshme për të identifikuar fletën e votimit për kryetar dhe fletën e votimit për këshill.

Znj. H. Vukaj: Pra, keni aplikuar edhe ngjyra të ndryshme në zgjedhje të tjera. Në vijim, do të thosha, në rast se një pigment do të ishte ndryshe, nuk do të shtonte ndonjë kosto?

Z. B. Kodra: Absolutisht, asnjë kosto.

Znj. H. Vukaj: Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit!

Z. B. Kodra: Thjesht është përdorur e njëjta ngjyrë që është përdorur në zgjedhjet e vitit 2021.

Znj. I. Nano: Në rregull. Zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Faleminderit, kryetare! Në nenin 25/1 të ndryshuar në datën 26 korrik 2024, pika 2, fjalia e fundit parashikon që fleta e votimit nga jashtë është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në respekt të kësaj norme të Kodit

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



6

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

Zgjedhor, ju keni propozuar, nëse mund ta shohim edhe aty, që për fletën e votimit nga jashtë elementi i veçantë dallues të jetë akronimi VJ. Aktualisht numri i të regjistruarve nga jashtë është diku te 98 mijë, po shkon drejt 100. Në pritshmëri, duke supozuar që do të ecë ky trend kërkesash për regjistrim dhe ky trend miratimesh nga ana e KQZ-së për trajtimin e kërkesave për regjistrim, duke marrë në konsideratë edhe faktin që është lejuar që jo vetëm të regjistrohesh, por edhe të votosh me dokumente identifikimi të skaduara, pavarësisht se në gjykimin tim kjo është e vonuar, për të incentivuar duhej bërë përpara datës 11 janar kur nisi procesi i regjistrimit, duke marrë në konsideratë edhe faktin që të gjitha fletët e votimit, supozojmë që mund të kemi 200, 250 mijë fletë votimi, 250 mijë shtetas shqiptarë me banim jashtë shtetit, të cilët e kanë fituar të drejtën e votës nga jashtë shtetit, mendoni se mund të kemi, pra a është e mjaftueshme kjo shenjë dalluese në fletën e votimit nga jashtë? Unë personalisht nuk e gjej. Do të ishte mirë ta shikonim. Kjo është fleta e votimit për brenda vendit dhe fleta e votimit për jashtë është me një shenjë të vogël dalluese.

Znj. P. Doçaj: Duke qenë se ne në interpretim të nenit 25, ku thotë që duhet të ketë një element dallues, për ta personalizuar fletën e votimit menduam që akronimi i votuesve nga jashtë mund të ishte ai elementi i veçantë dallues. Por mund të ishte edhe diçka tjetër. Propozimi ynë është i hapur.

Z. M. Çakaj: Dakord, ideja është që KQZ-ja, pasi përmbyll procesin e regjistrimit, në momentin që do të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ta dërguar nëpërmjet shërbimit postar, në dijeninë time do ta bëjë manualisht, do të përgatisë manualisht 200 mijë zarfe. Shanset që të gabosh në gjithë këtë proces janë shumë të mëdha lidhur me atë ndryshim aq të vogël. Pra, elementi i veçantë dallues në vlerësimin tim do të duhej të ishte shumë më dallues, dakord fleta, e njëjtë me të gjitha karakteristikat, por shumë më dallues elementi i

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



7

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

veçantë. E di, shumë mirë procesin, vijnë të paketuara, por shanset për t'u ngatërruar janë të mëdha, me ose pa dashje, gabimi njerëzor apo jo, të paktën ta minimizojmë gabimin njerëzor duke i dhënë edhe ne mundësinë rregullatore kësaj.

Znj. H. Vukaj: Të pyesim edhe zonjat dhe zotërinjtë e nderuar prezentë këtu: me sy të lirë a përbën shenjë dalluese të mjaftueshme për një numërues? Për mua personalisht jo. Imagjini numëruesin, se sa është sasia e fletëve të votimit që do të kalojë jo vetëm në kohë diellore, po edhe natën, do të numërojë edhe natën, a është në gjendje ta dallojë që kjo është një fletë votimi nga jashtë, dhe me akronim madje, as nuk thuhet "Fletë votimi nga jashtë", por ka një akronim mikroskopik, i cili e bën të vështirë me sy të lirë ta kapësh në gjendje normale, jo më ai që do të jetë numërues e do të jetë i lodhur pas një periudhe të gjatë numërimi. Kjo nuk është në konformitet me një shenjë të dukshme, e cila vërtet e bën të ekspozueshme një fletë, e bën evidente, pra ndihmon në evidencë, por edhe në transparencë në të njëjtën kohë. Pra, fletët e votimit nga jashtë të kenë vërtet elementin dallues.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Vukaj! Në fakt, lidhur me numëruesit, pa dyshim ajo shenjë nuk e bën shumë të dallueshme një fletë brenda vendit me fletën e votimit jashtë vendit, por numëruesit nuk do t'i ngatërrojnë, sepse numëruesit këtu në KQZ do të numërojnë vetëm fletët që vijnë me postë, numëruesit e tjetër janë në komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe vendet e numërimit të votave, por pa dyshim nuk i heq asnjë presje asaj që sapo thatë në lidhje me shenjën që duket e vogël dhe nuk e bën shumë të dallueshme qoftë gjatë prodhimit, qoftë gjatë administrimit këtu në KQZ përpara se të dërgohen përkatësisht në KZA apo jashtë vendit. Kemi ndonjë propozim, kolegë, lidhur me këtë që sapo thatë?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 8

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

Znj. H. Vukaj: Shenjë dalluese për mua personalisht, por edhe kolegu Çakaj ndan të njëjtin qëndrim, për fletën e votimit nga jashtë mund të ishte një ngjyrë e ndryshme nga fleta e votimit nga brenda dhe kjo përmbush kushtet e asaj karakteristike dalluese që Kodi imponon që këto të jenë të dallueshme në raport me sasinë e fletëve të votimit që do të grumbullohen nga votimi nga brenda.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Nisur nga të gjitha këto diskutime, referuar edhe sqarimit të administratës, duke qenë se kemi të bëjmë me një memorie historike të proceseve zgjedhore në Shqipëri, të paktën për sa i përket fletës së votimit nga brenda vendit, se kështu e kemi pasur këtë procesin, dhe deri diku nuk kemi pasur kontestime në raport me ngjyrën apo përmbajtjen e fletës së votimit nga brenda vendit, kështu që unë personalisht jam dakord në parim lidhur me të gjitha karakteristikat teknike dhe elementet e fletës së votimit nga brenda. Ndërsa në lidhje me fletën nga jashtë, u propozoj edhe kolegëve, ta ndajmë këtë akt, sot të shqyrtojmë, vlerësojmë e nëse biem dakord të miratojmë karakteristikat teknike të fletës së votimit nga brenda vendit dhe fletën e votimit nga jashtë ta ndajmë në një moment të dytë, mund të kemi edhe propozime për elementin e veçantë dallues në respekt të nenit 25/1, pika 2, të Kodit Zgjedhor, dhe sigurisht edhe një dakordësi. Kemi kohë.

Znj. H. Vukaj: Meqenëse edhe administrata ishte e hapur për të diskutuar elementet dalluese në versione të tjera, le të marrim kohë e të kemi versionin më të mirë.

Znj. P. Doçaj: Për pjesën e ngjyrës, duke qenë se neni 25 e ka të përcaktuar që fleta e votimit është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues, duke qenë se e kemi fletën të njëjtë apo ndoshta...

Znj. I. Nano: Të diskutojmë vetëm propozimin e parë ...

Znj. P. Doçaj: Në rast se do ta ndajmë, ideja është në propozimin e dytë...

Znj. I. Nano: Do ta diskutojmë.

Z. P. Doçaj: Ne jemi dakord.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj pati një propozim që gjatë mbledhjes së sotme ne të shqyrtojmë dhe eventualisht të miratojmë karakteristikat teknike të fletës së votimit që përdoret për zgjedhësit brenda vendit, për shkak se KQZ-ja ka një përvojë prej shumë e shumë vitesh që miraton karakteristikat teknike dhe pastaj në një moment tjetër me një akt të ri, ne të miratojmë karakteristikat teknike të fletës së votimit jashtë vendit, por me fokus tek shenja dalluese sipas nenit 25/1, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Kolegë, së pari, duhet të shtroj për votim këtë propozim. Jeni dakord? E miratojmë. Sot do të shqyrtojmë e do të diskutojmë çështjen e karakteristikave teknike të fletës së votimit që përdoret brenda vendit ose ta shohim si do ta riemërtojmë dhe pastaj pas konsultimeve, diskutimeve për të pasur një fletë votimi me një element sa më të dallues, me një shenjë sa më dalluese, do t'ju luteshim që të kishim një propozim të ri që nesër, që pasnesër, sa më shpejt. Unë e kuptoj që edhe pse fleta e votimit do të prodhohet më vonë, për efekte të edukimit zgjedhor, edhe zgjedhësit jashtë vendit të mësohen me idenë e fletës që do t'u vijë. Të kenë disa karakteristika parasysh.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

Pas kësaj dakordësie, pasi përfunduar shqyrtimin në parim, nëse nuk kanë kolegët diçka tjetër, nga partitë politike, kishte diçka në parim lidhur me këto që sapo diskutuam? Ne votuam me njëri-tjetri që të shqyrtojmë e të miratojmë sot fletën e votimit brenda vendit, karakteristikat teknike. Po, zoti Nuri.

Z. F. Nuri: Jo, në parim, nuk kemi kundërshtim që të veçohet akti dhe të diskutohet fleta e votimit nga jashtë në një moment të dytë. Për sa u përket elementeve teknike, qëndrimi i Partisë Demokratike, më duhet ta them edhe publikisht, është që elementi dallues të jetë tek ngjyra. Ne mendojmë që Kodi nuk e pengon këtë gjë, aq më tepër që dispozitat e Kodit, të rejat, të para disa muajve, janë me specifike dhe kanë pasur si synim që të ketë një dallim midis fletës së votimit nga brenda dhe fletës së votimit nga jashtë. Ky është qëndrimi ynë dhe këtë qëndrim do të mbajmë edhe në vijim.

Znj. I. Nano: Kjo do të mbetet për shqyrtim kur të kemi projektaktin e radhës. Në këtë moment do të diskutojmë fletën e votimit për brenda vendit. Zonja Xhina.

Znj. E. Xhina: Faleminderit! Edhe unë shpreh dakordësinë që të veçohen të dyja aktet, që fleta e votimit nga jashtë duhet të ketë një element më dallues se ky që na është paraqitur. Për sa u përket detajeve, mendoj se duhet të shprehemi në momentin e shqyrtimit.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhje për Kuvend të datës 11.5.2025”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

Miratohet me 5 vota pro!

Fillojmë me tekstin e projektvendimit, ku, sipas dakordësisë, do të na duhet të bëjmë disa ndryshime. Zoti Çakaj më ka kërkuar pak më herët të diskutojë për titullin.

Z. M. Çakaj: Duke qenë se ne morëm një vendim si Komision Rregullator për të bërë një ndarje të shqyrtimit të karakteristikave teknike të fletës së votimit si për brenda, ashtu edhe për atë nga jashtë, do të na duhet që në të gjithë përmbajtjen e aktit të kemi pikërisht këtë specifikim, pra edhe në titull, titulli të jetë “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për brenda vendit për zgjedhjet e Kuvendit të datës 11.5.2025” dhe kjo të transpozohet edhe në pikën 1 të dispozitivit, edhe tek titulli i lidhjes nr.1. Të mos bëj të njëjtin propozim në çdo moment. Pra, kudo në akt të jetë e specifikuar që do të jetë vetëm për brenda vendit.

Znj. I. Nano: Pra, për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që të kemi një harmoni edhe me terminologjinë që do të përdoret në aktin tjetër. Ndërkohë që unë kam që në preambul një diskutim. Duke qenë se ramë dakord që të mos votojmë sot fletën e votimit nga jashtë, do të duhet që referencën ligjore “nenin 25/1, pika 2” ta heqim, sepse ajo do të jetë bazë ligjore për aktin e radhës. Kemi propozimin e parë, ndryshimin në titull, në pikën 1 dhe në titullin e lidhjes nr.1.

Znj. H. Vukaj: Meqenëse kolegu ndërhyri tek pika 1 dhe meqenëse kjo pikë ka të bëjë me lidhjen nr.1, unë do të propozoja atë çfarë ngrita më herët drejtuar administratës, që në lidhjen nr.1, tek karakteristikat e para, pra te lloji i letrës, pas fjalës “dy shtresa”, të shtonim fjalët “me trashësi totale 117 mikrom”.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



Znj. I. Nano: Fillojmë me propozimet me radhë për t'i hedhur në votim. Propozimi i parë është: ndryshimi i titullit sipas propozimit të zotit Çakaj. Kush është dakord? Miratohet me 5 vota pro.

Propozimi i dytë: ndryshimi i preambulës për të hequr togfjalëshin “nenit 25/1, pika 2”. Kush është dakord? Miratohet me 5 vota pro.

Kalojmë në votimin nen për nen. Unë do ta rilexoj tekstin e projektvendimit sipas asaj që ramë dakord.

Pika 1. Miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11.5.2025, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në tekst kemi propozimin për të shtuar sipas asaj që tha kolegu Çakaj. E votojmë këtë dhe kalojmë te lidhja 1 për të votuar propozimet. Pra, ndryshimi në pikën 1 të projektvendimit “Fletës së votimit për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”. Kush është dakord? Miratohet.

Në fakt, pika 1 në përmbajtje ka lidhjen nr.1, kështu që tek lidhja nr. 1 kemi ndryshimin në titull njëlloj si propozoi kolegu Çakaj. Kush është dakord? Miratohet.

Po te lidhja nr.1 kemi propozimin e zonjë Vukaj pas fjalës “dy shtresa” të shtohen fjalët “me trashësi 117 mikrom” dhe me akronimin e mikromit, ju lutem. Kush është dakord? Miratohet.

Tek lidhja 1, të paktën tek ajo që na ka ardhur, edhe pse është një lloj lapsusi, të hiqen gjatë zbardhjes, nuk është për votim kjo, dy rreshtat e fundit. Pra, nuk po e kaloj për votim.

Votojmë në bllok pikën 1 pas gjithë ndryshimeve, që përfshijnë edhe ndryshimet në lidhjen nr.1. Kush është dakord? Miratohet.

Znj. H. Vukaj: Një pyetje për administratën, e cila sheshon ndonjë dilemë të mundshme në lidhje me QR Kodin. A është i lexueshëm ai nga të tretë, apo nga

njerëz të tjerë për veç votuesit? Cili do të ishte mekanizmi që do ta lexonte atë në rastet eventuale.

Znj. I. Nano: Zoti Kodra.

Z. B. Kodra: Po ta vini re, në këtë propozim, ndryshe nga votimet e kaluara, ne kemi hequr numrin serial të fletës së votimit. Në zgjedhjet e kaluara, duke qenë se ka pasur një debat në vend për mundësinë e identifikimit të votuesit nëpërmjet numrit serial të fletës së votimit, edhe pse në zgjedhjet e kaluara i gjithë ky numër serial bar kodi është printuar i enkriptuar dhe kodi i enkriptuar është dorëzuar në KQZ nga prodhuesi, që mund të lexohej vetëm nga ne, vërtet ajo kishte një numër serial që përbëhej nga numra dhe shkronja e enkriptuar, por nuk mund të deshifrohej. Ajo deshifrohej vetëm pasi të lexohej duke përdorur kodin e deshifrimit. Por këtë herë ne e kemi hequr fare numrin serial. Ky ka qenë një propozim i Komisionerit që ne nuk do ta përdorim më numrin serial në fletën e votimit për të shmangur çdo diskutim, keqkuptim të mundshëm.

Znj. H. Vukaj: Ju hiqni numrin serial, por renditja tashmë e atyre kodeve është ajo që ka qenë, apo e keni rendmëli, e keni shkartisur, siç thotë populli.

Z. B. Kodra: Sipas të dhënave, elementet që do të përmbajë QR Kodi janë: qarkun...

Znj. H. Vukaj: Dakord, zoti Kodra. Ato i kemi dhe i miratuam. Problemi është për transparencë të të tjerëve, të cilët ndoshta kanë dyshim te fleta e votimit, që mund t'i duket e lexueshme për hir të këtij elementi QR Kodi. Ndaj të pyeta.

Z. B. Kodra: Me sy të lirë QR Kodi nuk ...

Znj. H. Vukaj: Numri serial u hoq, por në fakt, por këto zbërthime të QR Kodit kanë të njëjtën vendosje si të ishte numri serial?

Z. B. Kodra: Po, të njëjtën vendosje, sepse numri serial shkruhej pas këtyre. Numri serial përbëhej nga 7 shifra, që shtohet pas dy shifrave të qarkut, dy shifrave të zonës dhe 6 shifrave të qendrës së votimit.

Znj. H. Vukaj: Pra, për hir të mungesës së atij numri serial, i cili ishte numri i fletës së votimit. Çfarë ishte ky numër.

Z. B. Kodra: Numri serial i fletës së votimit.

Znj. H. Vukaj: T'i sqarojmë për të tjerët, se ne jemi bërë shumë frekuentë me këtë proces. Kjo bëhet tashmë e palexueshme, sepse shkon deri në nivelin e ...

Z. B. Kodra: ...e qendrës së votimit. Me një fjalë, edhe sikur të ketë dëshirë dikush ta lexojë, fletët e votimit që përdoren brenda një qendre votimi janë të gjitha njësoj.

Znj. H. Vukaj: Cili do të ishte mekanizmi ose mjeti që i lexon? Keni ndonjë mjet që i lexon në mënyrë digjitale?

Z. B. Kodra: Me çdo lexues barkodi ose QR kodi ky numër lexohet. Në qoftë se printohet i enkriptuar, edhe pse lexohet, nuk kuptohet se çfarë të dhëne përmban.

Znj. I. Nano: Po, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Kisha edhe unë një pyetje. Kodi QR vendoset te kuadrati, ke katrori, sipër djathtas, apo jo? Do të ishte mirë që ta kishim një ose të paktën të ishte shkruar QR Kod, të paktën në specimen.

Znj. H. Vukaj: E keni templejtin e përdorur më përpara?

Z. B. Kodra: Unë kam një templejt të fletës së votimit të vitit 2021. Printohet nëpërmjet printerit digjital ku printohen të dhënat digjitale, që është numri i qendrës së votimit.

Z. D. Çaka: Me sa kuptova unë propozimin e kolegut Çakaj, ishte që në specimen të kishte një element identifikimi që këtu vendoset QR Kodi, apo jo?

Z. B. Kodra: Po.

Z. D. Çaka: Thjesht për lehtësi. Domethënë ku vendoset, jo si QR.

Z. M. Çakaj: QR.

Z. B. Kodra: Në rregull.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Me pikën 1 dhe me lidhjen nr.1 jemi në rregull. Vazhdojmë me pikën 2. “Përmasat e fletës së votimit përcaktohen në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen.” Zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Unë propozoj, duke qenë se procesin e printimit, e kërkesave, e prokurimit të fletës së votimit e kryen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në këtë akt ta autorizojmë se kush do ta përcaktojë përmasën ekzakte në varësi edhe të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

subjekteve zgjedhore, pra është një proces që i takon një momenti të dytë, pasi do të duhet të presim se sa subjekte zgjedhore do të kemi, sidomos për zonat zgjedhore ku ka kandidatë shumë, mund të përmendim Tiranën, që mund të jetë pak problem. Në këtë vendim ne të autorizojmë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve që të përcaktojë përmasat e fletës së votimit në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen.

Znj. I. Nano: Pra, në thelb, propozimi juaj është që përmasat e fletës së votimit përcaktohen nga KSHZ-ja, por në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore. Votojmë pikën 2 me propozimin e zotit Çakaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vazhdojmë. Pika 3. “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Të shtohet një pikë 4. “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 5. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, meqenëse akti u miratua në parim, nen për nen, pësoi edhe disa ndryshime, i ftoj kolegët të kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pasi miratuam në tërësi aktin dhe para se të kalojmë te zoti Nuri, që e ka kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës, do t’i lutesha administratës që të zbardhen sa më shpejt këto ndryshime, përfshirë edhe atë që thamë te specimeni dhe të përgatitet sa më shpejt edhe akti për karakteristikat e fletës së votimit për votuesit që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 6

**Data 6.02.2025
Ora 12:59**

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA:

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj. M. Çelmeta, znj. P. Doçaj, z. B. Kodra**
- **Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)**
- **OJQ: KRIIK**

Znj. I. Nano: Vazhdojmë me diskutimet jashtë rendit të ditës. Zoti Nuri.

Z. F. Nuri: Faleminderit, zonja kryetare! Ne si Parti Demokratike kemi një shqetësim në lidhje me votën e diasporës, me regjistrimin më saktë në platformën PER. Edhe herën e fundit pata rastin të bëja me dije publikisht denoncimin e deputetit Edmond Spaho, që e kishte bërë në rrjetin e tij social *facebook* për sa i takon regjistrimit të emigrantëve shqiptarë në diasporë, konkretisht në Greqi, por na kanë ardhur raportime të tjera që shkojnë përsëri në këtë drejtim. Bëhet fjalë konkretisht për denoncime që neve na kanë ardhur, raportime që individë të caktuar shkojnë në banesë të qytetarëve shqiptarë në Greqi dhe pretendojnë se i

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 6.02.2025*

vijnë nga ana KQZ-së për të kryer regjistrime. Unë e bëra thirrjen herën e kaluar, po e ripërsëris drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zotit Celibashi apo stafit të KQZ-së ne i kërkojmë që të dalin në një deklaratë publike dhe KQZ-ja ta bëjë mjaft të qartë që nuk është KQZ-ja institucioni që bën regjistrime në terren, aq më pak në banesat e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit. Pra, KQZ-ja duhet të distancohet dhe të kërkojë që të gjitha palët duhet të distancohen nga këto lloj praktikash. Është e papranueshme dhe ne kërkojmë që të ketë një sqarim publik në lidhje me këto shqetësime që na kanë ardhur. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Nuri! Nesër ka seancë Komisioneri? Në seancën më të parë të Komisionerit, ju jeni i pranishëm në përgjithësi, zoti Nuri, mund ta përsërisni kërkesën tuaj për të mbajtur këtë qëndrim. Çështje të tjera jashtë rendit të ditës nuk kemi.

Znj. H. Vukaj: Një kujtesë për administratën në lidhje me aktin e djeshëm, pra ndryshimet në vendimin nr. 9. Sa më shpejt.

Z. I. Nano: Sillini me shkrim ato që thatë zonja Vukaj dhe zoti Çakaj. Keni gjëra për t'i dërguar.

Z. H. Vukaj: Një fjali nga zoti Çakaj. Nuk është se e pengon ajo.

Znj. I. Nano: Mbledhjen e deklarojmë të mbyllur.